




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RROKUM TV
Sara KELEMENDI
Drejtoreshë
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2019/108 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për RROKUM TV
(Palë Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 maj 2013 ka nxjerrë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01. Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM-2013/01 nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 6 dhjetor 2019, ka sanksionuar me Vërejtje Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 6 paragrafi 3 dhe 4 dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3, të Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM-2013/01, edhe përkundër vendimit sanksionues të KPM-së, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM-2013/01.
3. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë prej datës 21 tetor 2019 deri me datën 10 nëntor 2019 ka bërë monitorimin e ofruesit të shërbimit medial të Palës Përgjegjëse, për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2013/01.
4. KPM në bazë raportit të monitorimit të datës 13 dhjetor 2019 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar filma artistik dhe dokumentar të cilat nuk i ka paralajmëruar dhe shoqëruar me shenjën përkatëse duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren KPM 2013/01.
5. KPM me datën 30 dhjetor 2019 i ka dërguar Njoftim për shkelje me të cilën e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM 2013/01. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e gjetura.

6. KPM me datën 8 janar 2020 ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës theksohet se të gjitha transmetimet dhe programet e televizionit të Palës Përgjegjëse në periudhën e cekur në njoftim (21 tetor deri 10 nëntor 2019) kanë qenë për një audience familjare dhe pa kufizime për ndonjë grup- moshe të caktuar.

Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 3, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01.

Neni 3, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2013/01 përcakton se:

“Subjektet transmetuese të cilat transmetojnë TV programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t’i paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstual dhe t’i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve në këtë rregullore”.

8. KPM bazuar në raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 3 paragrafi 3 të Rregullores KPM-2013/01, duke transmetuar dokumentar dhe filma artistik të cilët nuk i ka paralajmëruar dhe shoqëruar me shenjën përkatëse. Bazuar në nenin 3 paragrafi 3 të Rregullores KPM-2013/01 Subjektet transmetuese të cilat transmetojnë TV programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe ti paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstual dhe t’i identifikojnë me simbolin përkatës vizual.
9. KPM-së ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM-2013/01, dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të respektimit të Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM-2013/01, prandaj përmes kësaj KPM i rekomandon Komisionit që si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse të merret shkelja e vazhdueshëm edhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM-2013/01.
10. Prandaj, Komisioni duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 3, paragrafi 3 të Rregullores KPM-2013/01.


Vendim

11. Obligohet Pala Përgjegjëse që, duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 5, të Rregullores KPM-2013/01, të nxjerrë Kodin Praktik në të cilin do të përcaktojë standardet vetërregulluese për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët dhe të miturit, dhe këtë Kod të miratuar ta sjellë në KPM brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi.

12. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 3, paragrafi 3 të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01.

E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Muja FERATI
Kryetar



02.03.2020
Datë